

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6694
E enjte, 1 shtator 2022
çmimi 0.40 €

Serbia vendos afishe në pikat kufitare: Nuk e njohim pavarësinë e Kosovës



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PROTESTOHET KUNDËR DHUNËS NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE

PROTESTUESIT GJUAJNË ME NGJYRË TË KUQE QEVERINË DHE INSTITUCIONET E DREJTËSISË



Me brohoritjet "Mbrotjtje për vajzat dhe gratë", "Shteti fajtor", "Përdhunimi është krim", "Jo, do të thotë Jo", në Prishtinë u protestua kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave. Protesta u thirr nga Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist pasi u bë publik rasti i dhunimit të një

11 vjeçeje në Prishtinë nga pesë të dyshuar. Protestuesit hodhën ngjyrë të kuqe në drejtim të ndërtesës së qeverisë, Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit Gjyqësor. Ata kanë kërkuar dënim meritore për të dyshuarit e dhunimit të të miturës

MASHTI I GATSHËM PËR FILLIMIN E VITIT SHKOLLOR, SBASHK-U VAZHDON GREVËN



FAQE 7



HAZIRI: PO KËRCËNOHET PAQJA SOCIALE NË KOSOVË, QEVERIA KURTI PO PUNON SOT PËR NESËR

FAQE 3

OPINION

GJEJENI NJË ZGJIDHJE QË TË FILLOJË VITI SHKOLLOR!

F.7
KMDLNj



AKTUALE



ROTH NË SHKUP: NDRYSHIMET KUSHTETUESE SHPEJTOJNË RRUGËN DREJT BE-së

F.2

HOTELERIA, GASTRONOMIA, KËNGËTARËT, STILISTËT DHE SALLONET E BUKURISË I SHMANGEN TATIMIT

F.5

EKONOMI



ZRRE-ja: NUK DO TË KETË SHITRENJTIM TË ENERGJISË NË KOSOVË

F.8

QEVERIA VENDOS MASA TË REJA MBROJTËSE PËR PRODUKTET E NAFTËS

F.8

SPORT



SIGAL PRISTINA NË LIGËN ENBL

F.10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni Xhepcisht - Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A. DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

Roth në Shkup: Ndryshimet kushtetuese shpejtojnë rrugën drejt BE-së

SHKUP, 31 GUSHT - Deputeti gjerman Michael Roth i ka bërë thirrje Maqedonisë së Veriut që t'i miratojë ndryshimet kushtetuese për ta përsheptuar procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Roth, kryetar i Komisionit për Politikë të Jashtme në Bundestagun gjerman, i ka bërë këto deklarata pas një vizite që ka realizuar më 31 gusht në Shkup. Ndryshimet e Kushtetutës, me të cilat pakica bullgare në Maqedoninë e Veriut do të njëjhej si popull shtetformues, janë pjesë e dokumentit të njohur si "propozimi francez".

Ky propozim i ka hapur rrugë fillimit formal të negociatave të anëtarësimit midis Maqedonisë së Veriut dhe BE-së në muajin korrik. Megjithatë, ai është kundërshtuar nga opozita maqedonase, e cila ka thënë se minon shtetin maqedonas dhe ka shkaktuar protesta e tensione. Nga Qeveria në Shkup nuk japin ndonjë datë të saktë se kur mund të nisë procesi për ndryshimin e Kushtetutës, por kujtojnë se procesi i skringut duhet të përfundojë deri në nëntor të vitit të ardhshëm.

Roth ka thënë se ndryshimet kushtetuese nuk janë të lehta, por duhet të ndodhin me angazhimin e të gjitha



subjekteve politike. "E di që nuk është e lehtë për shumëkënd kur bëhet fjalë për ato ndryshime kushtetuese, por secili duhet ta pyesë veten - jo si mund ta ndihmojë partinë time - por si mund ta ndihmojë dhe të kontribuojë për vendin tim", ka

thënë Roth pas takimit me presidentin maqedonas, Stevo Pendarovski.

Ai i ka siguruar qytetarët maqedonas se ndryshimi i Kushtetutës dhe miratimi i propozimit francez nuk rrezikon identitetin e tyre kombëtar. "Kjo

është arsyeja pse tani është shumë e rëndësishme që edhe një herë të theksohet dhe të bëhet e qartë se BE-ja nuk është vetëm një treg i brendshëm dhe një komunitet që ka një monedhë, por është një komunitet që ka diversitet

kulturor dhe gjuhësor, dhe se askush nuk ka të drejtë të ndërhyjë në identitetin kulturor. Asnjë marrëveshje nuk do të jetë në gjendje të ndryshojë këtë pasi ky është parimi bazë mbi të cilin është ngritur BE-ja", ka thënë ai. Sipas tij, edhe "BE-ja ka obligim të jetë më e pranishme në Maqedoninë e Veriut, të jetë më e dukshme, të angazhohet më shumë, të ofrojë perspektivë për të rinjtë, veçanërisht në këto kohë të vështira kur mund të ndjejë zhgënjim dhe frustrim me BE-në".

Ndryshimet kushtetuese miratohen me dy të tretat e votave, apo me votat për të 80 prej 120 deputetëve të Kuvendit të Maqedonisë së Veriut.

Në një prononcim javën e kaluar, presidenti i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, ka thënë se "është shumë e vështirë të arrihet shumica e dy të tretave për ndryshimet kushtetuese në këtë përbërje parlamentare".

Maqedonia e Veriut e ka fituar statusin e shtetit kandidat në vitin 2005, por për nisjen e bisedimeve ka pritur 17 vjet për shkak të kontesteve të pazgjdhura me shtetet fqinje - fillimisht me Greqinë për çështjen e emrit, e tani me Bullgarinë për gjuhën dhe identitetin.

NASA me një tentim të ri për nisjen e raketës drejt Hënës

NJU-JORK, 31 GUSHT - Administrata Kombëtare Amerikane e Aeronautikës dhe Hapësirës (NASA) do ta bëjë përpjekjen e dytë të shtunën, më 3 shtator, për ta nisur raketën e saj të re Space Launch System (SLS) drejt Hënës. Përpjekja e parë më 29 gusht për të nisur këtë raketë në Hënë u anulua për shkak të problemeve teknike në njërin prej motorëve.

Pas mbledhjes së të dhënave, inxhinierët thanë se tani besojnë se e kanë kuptuar se pse njëri nga katër motorët e raketës nuk arriti të ftohej në temperaturën e kërkuar për operim. Inxhinierët thanë se kanë krijuar një strategji për t'u përballur me këtë problem gjatë tentimit të dytë për nisjen e raketës. "Ne kemi një plan që duhet të ndjekim në mënyrë që të mund ta arrijmë synimin", tha John Honeycutt, i cili menaxhon projektin e raketës së NASA-s, SLS. Lëshimi i raketës të shtunën është paraparë të ndodhë në orën 14:17, sipas kohës lokale. Raketa do të lëshohet nga Qendra Ajrore Kennedy në Florida.

Inxhinierët do të kenë dy orë kohë për ta lansuar raketën nga Toka. Raketa SLS është mjeti më i madh

që ka zhvilluar ndonjëherë NASA. Kjo raketë do ta dërgojë kapsulën e quajtur Orion në Hënë, fillimisht pa ekuipazh. Por, programi i ri i NASA-s, Artemis, synon që më pas të dërgojë njerëz në Hënë.

Kapsula Orion do të jetë në një mision 42-ditor rreth Hënës, përpara se të niset drejt Tokës dhe të përfundojë në Oqeanin Paqësor, afër Kalifornisë.

Objektivi kryesor i këtij fluturimi testues është që të shikohet nëse mbrojtja e kapsulës mund t'u mbijetojë temperaturave të larta me të rihyrë në atmosferën e Tokës.

NASA tha se misionet drejt Hënës janë pjesë e programit të saj për të mësuar më shumë se si të arrihet në planetin Mars.

Por, misionet e ardhshme të programit Artemis do të fokusohen në Polin Jugor të Hënës, ku ka kraterë me rezerva të akullit. "Artemis është një seri misionesh gjithnjë e më komplekse për ta eksploruar Hënë në përgatitje për misionet në Mars. Kur të shkojmë në Mars, sa më shumë që mësojmë se cilat janë burimet në dispozicion për ne dhe si mund t'i përdorim ato, aq më mirë do të jetë



për ne", tha për BBC, shkencëtarja kryesore e NASA-s, Kate Calvin.

Ekipi i inxhinierëve planifikon që të nisë procesin e ftohjes së motorëve të raketës SLS rreth 45 minuta më herët para kohës së paraparë për nisjen e raketës të shtunën, me shpresën se mund t'i ftohën motorët me kohë.

Por, kushtet e motit më 3 shtator

nuk parashikohet që të jenë më të favorshmet.


Aktualisht parashikohet se ka 60 për qind gjasa që të ketë reshje shiu dhe raketa SLS nuk lejohet që të niset nëse ka shi.

Për herë të parë në Hënë, Neil Armstrong dhe Buzz Aldrin shkëlën në vitin 1969, në kuadër të programit Apollo, duke nisur të

ashtuquajturën epokë të artë të eksplorimit të hapësirës.

Por, misionet e reja të NASA-s priten të jenë më ndryshe sesa të programit Apollo, pasi agjencia amerikane dëshiron që të dërgojë në Hënë gruan e parë dhe personin e parë me ngjyrë, duke treguar se eksplorimi i hapësirës është i hapur për të gjithë.

Serbia vendos afishe në pikat kufitare: Nuk e njohim pavarësinë e Kosovës



PRISHTINË, 31 GUSHT - Një ditë para se Kosova dhe Serbia ta nisnin reciprocitetin për heqjen dorë nga lëshimi i dokumenteve për hyrje-dalje për qytetarët e tyre që kalojnë kufirin midis dy shteteve, Serbia ka vendosur në pikëkalime kufitare një njoftim. Në pikëkalimin kufitar midis

Kosovës dhe Serbisë, në Jarinjë, në anën e Serbisë, janë vendosur njoftime ku thuhet se me mundësimi i kalimit të kufirit me dokumente të identifikimit të lëshuara nga Kosova bëhet "për arsye krejtësisht praktike" që të bëhet më e lehtë liria e lëvizjes, bazuar në marrëveshjen për lirinë

e lëvizjes që palët arritën në dialogun e Brukselit më 2011. "Kjo nuk mund të interpretohet si njohje e shpalljes së njëanshme të pavarësisë së Kosovës; nuk paragjykon përcaktimin e statusit final të Kosovës; nuk mund të interpretohet si heqje dorë nga Beogradi për të drejtat e dhëna

nën Rezolutën 1244 të vitit 1999 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara", thuhet në njoftimin e vendosur pranë pikave të kontrollit kufitar.

Më 27 gusht Kosova dhe Serbia arritën marrëveshje për heqjen e lëshimit të dokumenteve për hyrje-dalje. Serbia për 11 vjet ka lëshuar dokumente të tilla për shtetasit e Kosovës me të hyrë në territorin e Serbisë. Këtë pjesë të Marrëveshjes së lirisë së lëvizjes së vitit 2011 Kosova e aplikoi vetëm për disa orë më 1 gusht.

Vendimi i Qeverisë së Kosovës për dokumentet për hyrje-dalje dhe ai për reregjistrimin e makinave me targa serbe, rriti tensionet midis Prishtinës dhe Beogradit, që kulmuan me vendosjen e barrkadave në veri të Kosovës më 31 korrik dhe 1 gusht. Por, pasi serbët lokalë hoqën barrkadat pasditen e 1 gushtit, Qeveria e Kosovës u pajtua që ta shtyjë zbatimin e dy vendimeve për 1 shtator. Për këto dy vendime, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, më 18 gusht u takuan në Bruksel, në kuadër të dialogut të ndërmjetësuar nga blloku evropian. Por, ky rund përfundoi pa marrëveshje. Megjithatë, diplomatët e Shteteve

të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian shtuan përpjekjet e tyre për t'i bindur palët që t'i shmangin tensionet më 1 shtator.

Në këtë kuadër, Kosovën dhe Serbinë e vizituan i dërguari i posaçëm i ShBA-së për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, dhe i dërguari i BE-së për dialogun, Mirosllav Lajçak. Pak ditë pas vizitës së tyre në Prishtinë dhe Beograd, BE-ja njoftoi për marrëveshjen e arritur për dokumentet e udhëtimit.

Më 1 shtator pritet të hyjë në fuqi vendimi për reregjistrimin e makinave që kanë targa të lëshuara nga Serbia. Vlerësohet se në veri të Kosovës, të banuar me shumicë serbe, qarkullojnë 10 000 makina me targa me akronime të qyteteve të Kosovës - sikurse PR, PZ, KM, UR e të ngjashme të cilat Kosova i konsideron të paligjshme. Qeveria e Kosovës ka thënë se nga 1 shtatori deri më 31 tetor qytetarët që kanë makina me targa të tilla do të mund t'i reregjistrojnë ato në targa RKS - Republika e Kosovës.

Serbia ka kërkuar që serbët në veri të Kosovës të përdorin targa KS - që kanë status neutral ndaj shtetësisë së Kosovës, por kryeministri Kurti ka hedhur poshtë një propozim të tillë.

Haziri: Po kërcënohet paqja sociale në Kosovë, qeveria Kurti po punon sot për nesër

PRISHTINË, 31 GUSHT - Nënkrjetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lutfi Haziri, e ka fajësuar qeverinë Kurti për problemet me të cilat po përballen qytetarët, reduktimet e energjisë elektrike, rritjen e çmimeve dhe grevat e punonjësve publikë.

Haziri në një intervistë në emisionin "Përballje" në "Telegrafi.com" me kryeredaktorin Muhamet Hajrullahu ka thënë se në Kosovë po kërcënohet paqja sociale dhe kjo, sipas tij, po ndodh për herë të parë. "Për herë të parë po kërcënohet paqja sociale në Kosovë, pasi ka krizë energetike, sociale dhe ekonomike. Qeveria nuk e ka ndërmarrë asnjë masë. Paralajmërimi për rformatimi i qeverisë është i vonshëm. Kryeministri po tregohet i vonshëm në çdo punë. Është dashur ta menaxhojë këtë krizë në të cilën po hyjmë", është shprehur Haziri. Sipas tij, kjo qeveri ka mungesë të programit të punës dhe prioriteteve. "Në proceset e brendshme po punon sot për nesër, ndërsa në procese të mëdha si dialogu, e ka parimin një hap para e dy mbrapa", ka deklaruar nënkryetari i LDK-së. Më tutje, ka thënë se ballafaqimi me të vërtetën, krizat dhe proceset e vështira ekzekutivn po e nxjerrin në pozitë defantiste edhe karshi partnerëve. "Përballja me e vështirë është me vetveten, pra me të kaluarën dhe të tashmen e kryeministrit Kurti.



Mungon dialogu social. Problemi i energjisë është mosveprimi, injorimi dhe neglizhimi nga ana e qeverisë. Për energjinë prej vitit të kaluar ne kemi propozuar planin 10

pikësh. Kemi thënë se qeveria duhet të fillojë përmes mekanizmave të vet menaxhimit të problemit të rrymës në shkurt dhe deri në gusht përfundon procesi i stabilizimit me energji",

është shprehur Haziri. Në këtë intervistë Haziri ka folur edhe për takimin e djeshëm me kryeministrin Albin Kurti, i cili i ka ftuar liderët opozitarë për t'i informuar lidhur me dialogun

me Serbinë. Haziri e ka quajtur të vonshëm këtë takim, ndërsa e ka akuzuar qeverinë Kurti se po i fsheh dëshimet në politikën e brendshme prapa negociatave me Serbinë.



PROTESTOHET KUNDËR DHUNËS NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE

Protestuesit gjuajnë me ngjyrë të kuqe qeverinë dhe institucionet e drejtësisë

Me brohoritjet “Mbrotjtje për vajzat dhe gratë”, “Shteti fajtor”, “Përdhunimi është krim”, “Jo, do të thotë Jo”, në Prishtinë u protestua kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave. Protesta u thirr nga Kolektivi për Mendim dhe Veprim Feminist pasi u bë publik rasti i dhunimit të një 11 vjeçeje në Prishtinë nga pesë të dyshuar. Protestuesit hodhën ngjyrë të kuqe në drejtim të ndërtesës së Qeverisë, Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit Gjyqësor. Ata kanë kërkuar dënim meritore për të dyshuarit e dhunimit të të miturës

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 31 GUSHT - Qytetarë të shumtë në Prishtinë kanë protestuar më 31 gusht kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave. Protesta është thirrur nga Kolektivi

për Mendim dhe Veprim Feminist pasi u publikua rasti i dhunimit të një 11 vjeçeje në Prishtinë nga pesë të dyshuar.

Me brohoritjet “Mbrotjtje për vajzat dhe gratë”, “Shteti fajtor”, “Përdhunimi është krim”, “Jo, do të thotë Jo”, “Nuk po ndihem e sigurt”

“Edhe sa”, qytetarët marshuan nga sheshi “Zahir Pajaziti” drejt ndërtesës së Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Qeverisë së Kosovës. Protestuesit hodhën ngjyrë të kuqe në drejtim të ndërtesës së Qeverisë, Ministrisë së Drejtësisë dhe Këshillit Gjyqësor. Ata kanë

kërkuar dënim meritore për të dyshuarit e dhunimit të të miturës. Të njëjtën gjë bënë edhe ndaj ndërtesës së Qeverisë së Kosovës. “Rasti i përdhunimit të të miturës është alarm për të gjithë ne, pikë së pari për shtetin i cili edhe sot vazhdon të jetë në anën e dhunuesve. Është pikërisht ky sistem patriarkal, me të gjitha patericat e veta, ai i cili është duke prodhuar vazhdimisht përdhunues”, ka thënë një nga organizatorët e protestës. Protestuesit u ulën në shkallët e ndërtesës së qeverisë e cila mbrohej nga policia.

Sipas protestuesve, vetëm në gjashtëmuorin e parë të këtij viti në Policinë e Kosovës janë raportuar 36 raste të dhunimit. Prandaj, sipas tyre, rasti i dhunimit të të miturës në Prishtinë nuk është vetëm “një ngjarje e shëmtuar dhe e trisht”, por “shpërfajtoje e dhunës sistematike që vajzat dhe gratë në Kosovë e përjetojnë në baza ditore”. Protestuesit patën edhe tri kërkesa për institucionet. Ata kërkuan krijimin e mekanizmave efektivë për trajtimin me dinjitet për të mbijetuarat e dhunës seksuale, trajtimin e drejtë të rasteve të



Hoteleria, gastronomia, këngëtarët, stilistët dhe sallonet e bukurisë i shmangen tatimit

PRISHTINË, 31 GUSHT - Drejtori i Përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ilir Murtezaj, ka mbajtur konferencë për medie, përmes së cilës ka njoftuar se ka realizuar aktivitete në terren te veprimtaria e gastronomisë/hotelisë, këngëtarëve, stilistët, si dhe salloneve të bukurisë. Murtezaj ka thënë se ATK-ja ka mbledhur informacione të ndryshme, të cilat e vërtetojnë aktivitetin e gastronomisë/hotelisë, këngëtarëve, stilistët, si dhe salloneve të bukurisë, ku për secilin kemi mjaftueshëm informata për të bërë vlerësime tatimore.

Në këtë konferencë u theksua se sezoni i verës shumëfishon aktivitetet e lartpërmendura, të cilat, bazuar në aktivitetin që kanë janë si një zinxhir, pasi që kryesisht në këtë sezon janë shumë ndeja të ndryshme si në restorante ashtu edhe në diskoteka, në të cilat ndërlihen pjesa e këndimit ose dj, si dhe përgatitja nga sallonet e bukurisë dhe stilistët.

Ai ka thënë se për këtë qëllim në fillim të këtij viti kanë dizajnuar projektin për akomodim dhe shërbime ushqimore, i cili, bazuar në të dhënat e përmbushjes gjatë vitit 2021, renditet si një ndër industritë me nivel të lartë të mospërmbushjes së detyrimeve

tatimore, andaj edhe është pjesë e planeve specifike të përmbushjes për grupet e identifikuara me rreziqe të larta për vitin 2021.

Murtezaj, ndër të tjera, përmendi problemet më specifike, të dalta nga sistemet dhe modulet e ndërhuara përbrenda ATK-së, të cilat kanë kontribuar në këtë përzgjedhje të trajtimit të kësaj industrie "pagesa përgjithësisht të ulëta, me një kontribut të vogël në të hyra, pavarësisht numrit të madh të tyre; mosdeklarimi i punëtorëve dhe pagesa cash e tyre; mosdeklarimi apo nëndeklarimi i ahengjeve dhe mosmbajtja e evidencave lidhur me këngëtarët gjatë mbrëmjeve muzikore; moslëshimi i kuponëve fiskalë; pagesat po ashtu në cash të realizuara në mes të konsumatorëve dhe bizneseve gjatë organizimit të ahengjeve të ndryshme; si dhe mosmbajtja e tatimit në qira apo nën-deklarimi i saj".

Në fund të kësaj konference drejtori i ATK-së u ka bërë thirrje të gjithë personave, bizneseve, të cilat gjatë kësaj sezone kanë pasur aktivitete të shtuara të deklarojnë dhe paguajnë saktë obligimet e tyre që i përcakton Legjislacioni Tatimor në fuqi, në të kundërtën ka thënë se janë të obliguar që të fillojnë hapjen e kontrolleve si dhe



ndëshkimet për mosdeklarim, e cila, sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, konsiderohet si vepër penale. "I

bëjmë thirrje që deri në afatet e rregullta me datën 20 të muajit shtator dhe 15 tetor, të deklarojnë dhe paguajnë obligimet tatimore,

pasi që pas këtyre afateve veprimet e ATK-së nuk do të jenë më thirrje, por veprime konkrete", ka thënë drejtori i ATK-së.



dhunës ndaj grave dhe dënime meritore për abuzuesit si dhe legalizimin dhe përdorimin e gazit irritues për vetëmbrojtje.

Në protestë ka marrë pjesë edhe lideri i PDK-së, Memli Krasniqi, i cili ka thënë se këto ditë, të gjithë jemi të shokuar nga rasti makabër i dhunimit të vajzës 11-vjeçare në Prishtinë. "Dhe, për më keq, ky nuk është një rast i izoluar i dhunës ndaj vajzave dhe grave në Kosovë. Prandaj, shteti, urgjentisht dhe me vendosmëri, duhet të reagojë në të gjitha instancat për ta rritur ndërgjegjësimin, për ta përmirësuar edukimin, krijuar sigurinë dhe garantuar drejtësinë për vajzat dhe gratë. Të veprohet sot, që të dërgohet mesazh i qartë të të gjithë dhunuesit, se shteti, por edhe shoqëria, do të mbrojnë vajzat dhe gratë me forcën e palëkundur të ligjit", ka thënë Krasniqi.

Autoritetet në Kosovë kanë

arrestuar pesë autorët që dyshohet se kanë dhunuar të miturën në Prishtinë më 27 gusht në Prishtinë. Ndaj pesë prej tyre është shqiptuar masa e paraburgimit prej një muaji.

Në mesin e të arrestuarve janë edhe tre persona të mitur.

Dhunimi thuhet se ka ndodhur më

27 gusht në një park në Prishtinë. Viktima, sipas Policisë së Kosovës, është dërguar në një strehimore. Edhe më 30 gusht në Prishtinë para Teatrit Kombëtar është mbajtur një protestë, përmes së cilës, qytetarët kanë kërkuar që të bëhen publike emrat e të dyshuarve për dhunë seksuale.



Edhe një dorëheqje për rastin e dhunimit të 11 vjeçes në Prishtinë

Ali Gashi, që deri më tani ka drejtuar Drejtorinë për Trajtimin e të Burgosurve dhe të Miturve në Shërbimin Korrektues të Kosovës, ka dhënë dorëheqje pas rastit të dhunimit të një 11 vjeçare në Prishtinë. "Dorëheqja ka ardhur si akt moral i Gashit, pasi që njëri nga të dyshuarit për dhunim ka qenë në mbajtje të dënimit në institucionet korrektuese për disa vepra penale", thuhet në njoftim. Kjo dorëheqje vjen një ditë pasi Samedin Mehmeti dha dorëheqje nga detyra e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Kosovës për "arsye personale dhe ndërgjegje profesionale" sa i përket rastit të fundit të dhunës seksuale ndaj të miturës në Prishtinë.

Nisin punimet për renovimin e Shtëpisë së Kulturës "Xhemajli Berisha" në Prizren

Prizren, 31 gusht - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka bërë me dije se kanë

filluar punimet për renovimin e Shtëpisë së Kulturës "Xhemajli Berisha" në Prizren, projekt i cili

është investim i Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, me vlerë prej 750 mijë eurosh. Ky

objekt ekziston nga vitet '60 dhe tani po jetësohet ideja për renovimin e tërësisht të tij.



Krusha e Madhe ndezi flakadanë në Ditën e të Pagjeturve

RAHOVEC, 31 GUSHT - 1 617 të pagjeturit e luftës, mes tyre 103 nga komuna e Rahovecit, janë plaga më e rëndë e që dhemb më së shumti për më shumë se dy dekada. "As të gjallë, as të vdekur, as me më të dashurit e tyre e as në varre. Fati i të zhdukurve është barrë e rëndë për familjet e të zhdukurve, por edhe për tërë popullin shqiptar, i cili, ndonëse ngadhënjimtar nga lufta e fundit në Kosovë, doli me humbje të mëdha", ka thënë kryetari i Rahovecit, Smajl Latifi.

Ai ka thënë se në Ditën Ndërkombëtare të të Zhdukurve me Dhunë, kujtojmë dhe nderojmë njerëzit tanë, që edhe pas 23 vjetësh ende janë të pagjetur. "Kjo plagë që na ngacmohet dhe na përcjell në secilën ditë, tash e më shumë se dy dekada, mbetet plaga, sfida dhe obligimi ynë moral më i madh institucional si dhe ndërkombëtar që nga paslufta. Në ditën kur bota kujton personat e zhdukur, ne kujtojmë 103 të pagjetur në komunën e Rahovecit, ku 64 të pagjetur janë vetëm në Krushë të Madhe, pa harruar edhe profesorin dhe politologun e shquar Ukshin Hoti. Gjithë këto fakte dëshmojnë mizorinë e madhe të aparatit shtetëror kriminal të Serbisë

ndaj qytetarëve të Kosovës", ka thënë Latifi.

Ai ka theksuar se si çdo vit edhe sivjet bashkëndiejmë me dhimbjen e familjarëve, ankthin dhe pritjen deri tash të pashpresë që kanë ata. "Sonte, kushtuar të pagjeturve, ndezëm flakadanët në shenjë solidariteti, nderimi dhe lutjeje për ndriçimin e fatit të tyre. Është obligim yni shtetëror që të punojmë përditë, pa u ndalur, për ta zbardhur fatin e të pagjeturve, si një e drejtë themelore dhe e pakontestueshme e viktimave dhe familjarëve, e cila vazhdon për 23 vjet t'u mohohet e të mbahet peng nga shteti serb, i cili bëri krime monstruoze e gjenocid kudo në Kosovë, po ashtu, krime të shumta (10 masakra) në komunën e Rahovecit, duke përfshirë edhe masakrën e 26 marsit 1999 në Krushë të Madhe", ka thënë kryetari Latifi.

Ai ka thënë se nuk do të ndalen asnjëherë së kërkuari shpjegim për fatin e tyre. "Do të jemi përherë pranë familjeve të të zhdukurve deri në verdiktin final të drejtësisë si mënyrë e vetme për t'i qetësuar shpirtat e trazuar të tyre nga vuajtjet mbi dydekadëshe", është shprehur Latifi.



Komuna e Podujevës nënshkruan memorandum me organizatën IOM



PODUJEVË, 31 GUSHT - Kryetari i komunës së Podujevës, Shpejtim Bulliqi, ka nënshkruar memorandum bashkëpunimi me Igballe Ymeri, përfaqësuesen e Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM), për realizimin e projekteve për furnizimin me laboratorë shkencorë dhe mjete të konkretizimit për ShFMU "Luigj Gurakuqi" në Batllavë dhe për kabinetin muzikor me instrumente të ndryshme

muzikore për ShFMU "Naim Frashëri" në Podujevë. Vlera e përgjithshme e të dy projekteve është 22 388 euro, ku donatorë janë Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë me 15 730 euro, ndërsa komuna e Podujevës participon me 6 658 euro. Këto projekte zbatohen në kuadër të programit EU-CSP-IV dhe zbatohen nga organizata IOM. Kryetari Bulliqi falënderoi organizatën IOM për

bashkëpunimin, duke u zotuar që edhe në të ardhmen do të vazhdojë bashkëpunimi i ngushtë për realizimin e projekteve në interes të komuniteteve pakicë në Podujevë. Në takim ishin të pranishëm edhe nënkryetarja e komunës së Podujevës, Marigona Lahu, drejtori i drejtorisë së Arsimit, Avni Fetahu dhe udhëheqësi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, Liman Zeqiri.

Kadeti i FSK-së, Lulzim Muqolli, diplomoi në Akademinë Ushtarake të Forcave të Armatosura të Turqisë

PRISHTINË, 31 GUSHT - Kadeti Lulzim Muqolli ka diplomuar në drejtimin e mbrojtjes ajrore me sukses të lartë në mesin e 902 kadetëve turq dhe 52 kadetëve ndërkombëtarë nga

11 shtete të ndryshme të botës. "Kadet Muqolli i dëshirojmë suksese në karrierën ushtarake në ushtrinë tonë, kurse shprehim falënderim dhe mirënjohje të thellë për

Republikën e Turqisë si vend i rëndësishëm partner yni, për mbështetje në shtimin e kadrove tona profesionale", ka shkruar në "Facebook" ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj.



MAShTI i gatshëm për fillimin e vitit shkollor, SBASHK-u vazhdon grevën

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 31 GUSHT - Ministria e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit (MAShTI) ka bërë me dije se janë bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2022/2023. Nga MAShTI thanë se i kanë bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e vitit shkollor më 1 shtator, por mësimdhënësit në Kosovë vazhdojnë të jenë në grevë që nga 25 gushti.

Ministria Arbërie Nagavci në një konferencë për medie mbajtur më 31 gusht u kërkoi punëtorëve të arsimit që ta ndërpresin grevën. "Jemi informuar se të gjitha shkollat kanë bërë përgatitjet e duhura për fillimin e procesit mësimor. Të gjithë janë deklaruar për rëndësinë e fillimit të vitit të ri shkollor më 1 shtator. Pres dhe kërkoj që të mos ketë grevë në sektorin e arsimit. Fëmijët e presin fillimin e vitit shkollor", ka thënë Nagavci.

Kërkesa kryesore e sindikatave të këtyre punëtorëve, drejtuar Qeverisë së Kosovës, është ndarja e nga 100 eurove për punëtorët derisa të hyjë në fuqi Projektligji për Pagat.

Në grevë, përveç punëtorëve të arsimit, janë edhe shërbyesit civilë në institucionet lokale dhe qendrore të Kosovës.

Ministria Nagavci ka thënë se të gjitha kërkesat e punëtorëve të arsimit janë të përfshira në Projektligjin e ri për Pagat.

Kryetari i SBASHK-ut, Rrahman Jasharaj, në një konferencë për medie ka bërë me dije se të enjten nuk do të ketë mësim dhe se greva do të vazhdojë. "Nesër është 1 shtatori. Po të kishim angazhim të sinqertë të shtetit tonë, nesër do të kishim fillim të vitit shkollor por, fatkeqësisht, pasi që mungon dialogu, greva do të vazhdojë. Kjo do të thotë që edhe nesër punëtorët e arsimit do të jenë në grevë dhe ajo do të vazhdojë edhe më tutje derisa qeveria ta fillojë realizimin e kërkesave tona", ka thënë Jasharaj.

Ministria e Punëve të Brendshme e ka proceduar Projektligjin për Paga në konsultime paraprake më 17 gusht. Projektligji duhet të kalojë procedurat e konsultimeve paraprake dhe publike si dhe, pas miratimit në Qeveri e Kuvend, do të publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyn në fuqi tetë muaj pas publikimit në këtë gazetë.



REAGIM I KMDLNJ-SË

Gjejeni një zgjidhje që të fillojë viti shkollor!

Për shkak të shpërfilljes së kërkesave të SBASHK-ut nga Qeveria e Kosovës, sindikalistët janë në ditën e pestë të grevës duke vënë në rrezik fillimin e rregullt të procesit arsimor që fillon me datë 1 shtator. Qeveria e Kosovës, në vend se të propozojë një zgjidhje përafuese, qoftë edhe kalimtare, është treguar shumë e ngurtë dhe hakmarrëse ndaj një organizimi dhe veprimi sindikalist që është tërësisht në përputhje me ligjet në fuqi.

KMDLNj gjithnjë është deklaruar se greva është masë e skajshme dhe e fundit pasi të jenë shterur të gjitha mundësitë për tejkalim të situatës. KMDLNj mendon se ende ka hapësirë për një marrëveshje të negociuar dhe të afatshme nëse ekziston vullneti i palëve "ndërluftuese". Ministria e Financave, me veprimin për të shkaktuar përçarje midis grevistëve duke kërkuar lista diferencuese se kush janë pjesëmarrës në grevë për t'i penalizuar me shkurtime të pagave, në mënyrën më flagrante po i shkel të gjitha dokumentet ndërkombëtare dhe kombëtare për të drejtat e njeriut duke e portretizuar qeverinë e Kosovës si



dhunuese e këtyre të drejtave. Përpjekje që greva të ndërlihet me procese politike dhe rrezikim të qeverisë nuk është e bazuar në asnjë fakt shkak se greva ka kërkesa të natyrës ekonomike dhe sociale e jo kërkesa politike. Për të tejkaluar situatën, SBASHK-u duhet të tërhiqet nga kërkesat maksimaliste kurse kryeministri Kurti, fillimisht dhe

me urgjencë duhet ta shkarkojë ministrin Murati i cili është pengesa kryesore për tejkalimin e situatës së krijuar. Në disa shtete të rajonit, për shkak të inflacionit të lartë, krizës ekonomike që kanë trende globale, janë rritur rrogat e punëtorëve të arsimit kurse më Kosovë nuk ka asnjë vendim nga qeveria se do të ndodhë një gjë e tillë, jo për punëtorët e arsimit por

për asnjë kategori në kohën kur kemi përkeqësim galopant të gjendjes ekonomike. KMDLNj është kundër çdo linçimi që po iu bëhet grevistëve dhe drejtuesve të saj për faktin se ata po e shfrytëzojnë një të drejtë të garantuar me ligj e që konsiderohet si e drejtë elementare e njeriut, e drejta për organizim dhe veprim të lirë

sindikalist.

Ndërkaq, arsyetimi se sindikatat duhet vet të paguajnë grevistët shkak se kanë buxhet vetjak duke përmendur shifra konkrete është kërcënim i pandershëm i një ministri që, përmes inkriminimit të mundshëm t'i detyrojë grevistët ta ndërpresin grevën. Shkarkimi i ministrit Murati për shkak të dhunimit të të drejtave sindikaliste, të drejtave të njeriut që duhet të mbrohen me ligj dhe i cili në mënyrë të pashtrëllt kërcënon dhe shantazhon grevistët, krijon kushte për arritje të një marrëveshjeje të pranuar nga të dyja palët. Po të mis ishte një përkeqësim i thellë i krizës ekonomike siç është ky në Kosovë, KMDLNj, pa asnjë dyshim do të kundërshtonte kërkesën për rritje të kompensimit material që e kërkon SBASHK-u, gjithnjë duke ua mbrojtur të drejtën për protestë dhe grevë. Në rrethanat e krijuara KMDLNj përkrahë çdo kërkesë për rritje të pagave apo kompensimit, sidomos për kategoritë e rrezikuara dhe komunitetet e marginalizuara. Për KMDLNj është e pranueshme çdo marrëveshje e palëve e që mundëson fillimin e vitit shkollor.

Dy të vdekur dhe 191 raste të reja me Covid-19 në Kosovë

Prishtinë, 31 gusht - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se dy persona me Covid-19 kanë vdekur në 24

orët e fundit. MSh-ja ka njoftuar se janë konfirmuar 191 raste të reja pozitive me Covid-19, ndërsa janë

testuar 926 persona. Të dhënat e publikuara nga MSh-ja tregojnë se në 24 orët e fundit janë vaksinuar

30 persona, ndërsa janë shëruar 255 persona. Numri i rasteve aktive në Kosovë është 1 325.



ZRRE-ja: Nuk do të ketë shtrenjtim të energjisë në Kosovë

PRISHTINË, 31 GUSHT - Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka bërë me dije se nuk ka rritje të çmimit të energjisë në Kosovë. Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) kishte kërkuar shtrenjtimin e tarifave të energjisë deri në 88 për qind për amvisëritë dhe deri në 70 për qind për bizneset.

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) i ka kthyer përgjigje negative Kompanisë Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) pas kërkesës për shtrenjtim të energjisë elektrike deri në 88 për qind. Kjo vjen pasi qeveria ka vendosur për ndarje të subvencionit me të cilën kanë pushuar rrethanat për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale të FSHU-së, respektivisht të tarifave të energjisë elektrike për konsumatorët me të drejtë të Shërbimit Universal. “Me vendimin e Qeverisë së Kosovës të datës 24.08.2022, për ndarjen e subvencionit kanë pushuar rrethanat për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale të FSHU-së, respektivisht të tarifave të energjisë elektrike për konsumatorët me të drejtë të Shërbimit Universal”.

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 9 gusht 2022 ka pranuar aplikimin për Shqyrtim të Jashtëzakonshëm të të Hyrave të Lejuara Maksimale për Furnizuesin me Shërbim Universal (FSHU).

Ndër të tjera, në kërkesën e saj FSHU thekson se në mungesë të rimbursimit të mjeteve të subvencionit nga Qeveria e



Republikës së Kosovës të shumës prej 32.8 milionë eurove për periudhën 9 shkurt - 30 qershor 2022 është tejkalluar pragu i materialitetit prej 5-përqindësh siç përcaktohet në Rregullën e të Hyrave të FSHU-së, duke mundësuar kështu hapjen e shqyrtimit të jashtëzakonshëm.

ZRRE në përputhje me Rregullën për Përcaktimin e të Hyrave të Lejuara për FSHU-në, ka analizuar me kujdes aplikacionin e FSHU-së dhe konstaton se ngjarja e jashtëzakonshme nuk ka qenë nën kontrollin e FSHU-së dhe se mungesa e subvencionit të Qeverisë së Kosovës do ta tejkallonte pragu e materialitetit prej 5 % në të Hyrat e Lejuara Maksimale të FSHU-së, e cila do

ta hapte shqyrtimin e jashtëzakonshëm të tarifave për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal.

Qeveria e Kosovës më 24 gusht ka aprovuar kërkesën e Ministrisë së Ekonomisë për ndarje buxhetore në shumën prej 41 milionë eurosh lidhur me Pakon e Ringjalljes Ekonomike për zbatimin e Masës 3.7 - Mbështetje në tejkallimin e krizës energjetike.

ZRRE thotë se gjatë muajve në vazhdim do të monitorojë nga afër gjendjen e kostove të sektorit të rregulluar të energjisë elektrike dhe do t'i ndërmarrë hapat e nevojshëm në përputhje me mandatin mandati të saj ligjor. Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO) kishte dorëzuar më 12

gusht në Zyrën e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) një propozim për tarifa të reja të energjisë elektrike, i cili do të shtrenjtonte rrymën deri në 88 për qind për amvisëritë dhe deri në 70 për qind për bizneset.

Sipas kësaj kërkesë, tarifa e ulët për ata që shpenzojnë nën 800 kilovat në orë, nga 2.89 centë është propozuar të bëhet 5 e 43, ndërsa e larta për këta konsumatorë nga 6.75 në 12.86. Ndërsa, për ata që shpenzojnë mbi 800 kilovat, është propozuar që tarifa e ulët të bëhet nga 5.90 në 11.09, derisa e larta nga 12.52 në 23.53.

Kurse që nga 15 gushti qytetarët e Kosovës janë duke u përballur me reduktimet e rrymës si pasojë e rënies së blloqeve të termocentraleve në Obiliq, por

edhe krizës me energji elektrike. Krahas territ, qytetarët e kanë hallin se si të sigurojnë ngrohjen për këtë dimër.

Në fillim të këtij muaji deputetët e Kuvendit të Kosovës me 68 vota për, asnjë kundër e abstenim, kanë votuar vendimin e qeverisë për vendosjen e masave emergjente në furnizimin me energji elektrike. Këto masa do të mbesin aktive për 60 ditë. “Masat e marra do të mbesin në fuqi për 60 (gjashtëdhjetë) ditë pas aprovimit nga Kuvendi i Kosovës. Kuvendi mund të vazhdojë këtë afat për periudha të njëpasnjëshme prej 30 (tridhjetë) ditësh me shumicë të votave të deputetëve të Kuvendit të pranishëm në seancë, deri në 180 (njëqind e tetëdhjetë) ditë”.

Qeveria vendos masa të reja mbrojtëse për produktet e naftës



PRISHTINË, 31 GUSHT - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) ka marrë vendim që të vendosë masa mbrojtëse për produktet e derivateve të naftës. Sipas këtij vendimi, marzha tregtare maksimale e lejuar me shumicë është dy centë për litër, kurse çmimi maksimal i lejuar i shitjes me pakicë 12 centë për litër naftë.

Në arsyetimin e këtij vendimi, thuhet se “MINT-i ka monitoruar tregun e produkteve të naftës dhe çmimet e furnizimit nga importi. Në bazë të raportit të Inspektoratit të Tregut është evidentuar mospërputhje e çmimeve në Kosovë në krahasim me lëvizjet në tregjet botërore”. “Kjo përbën shkas për rregullimin e çmimeve dhe caktimin e masave të tjera mbrojtëse”, thuhet në vendim. Ky vendim do të jetë në fuqi për 30 ditë.

Aktualisht në tregun e Kosovës një litër naftë kushton deri në 1.80 euro, kurse një litër benzinë

deri në 1.50 euro.

Qeveria e Kosovës, në muajin qershor, kishte marrë vendim për caktimin e çmimit tavan vetëm për derivate të naftës.

Tavani i çmimit të tyre ishte përcaktuar çdo 24 orë.

Naftëtarët në Kosovë më 9 qershor i kishin kërkuar kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, që të ruhet ekonomia e tregut të lirë dhe që minimalisht marzha (çmimi maksimal) të jetë: për shitje me shumicë 3 për qind dhe për shitje me pakicë 12 për qind.

Edhe në muajin mars Qeveria e Kosovës pati marrë vendim që t'i përcaktojë çmimet shitëse maksimale apo marzhat tregtare me shumicë dhe pakicë. Sipas këtij vendimi, marzha më e lartë tregtare ishte deri në 4 për qind të çmimit të shitjes, ndërsa për shitësit me pakicë marzha më e lartë ishte në 6 për qind.

Çmimet dhe kërkesa për naftë janë rritur në tregjet ndërkombëtare pas ndërhyrjes ushtarake të Rusisë në Ukrainë.

Procesi i Rosisë kundër Gorbaçiovit: Minutë pas minute

Pas grushtit të shtetit të dështuar më 1991, frymëzuesi i perestrojkës kthehet në liri, ama vetëm për të asistuar në momentet e fundit të Bashkimit Sovjetik. Bota kishte ndryshuar. Kronika, minutë pas minute, e dorëzimit final

Moskë. Liria e Mikhail Gorbaçiovit ka zgjatur pak. I dalë gjallë nga 4 ditët e robërisë në duart e puçistëve, themeluesi i perestrojkës e gjen veten rob të Parlamentit rus, në duart e Boris Jelcinit dhe të deputetëve të tij: i lirë të lëvizë, të flasë, të kthehet në Kremlin, në rast se do, por politikisht nën ruajtje, i nënshtruar vullnetit dhe deri poshtërimëve të bashkëbiseduesve të tij.

Kishte shkuar në Shtëpinë e Bardhë mbi Moskovë, siç e quanin qytetarët Parlamentin e Rosisë, për t'u bërë homazh ligjvënës të republikës më të madhe të Bashkimit Sovjetik dhe sidomos presidentit të tyre, Boris Jelcinit, që me një rezistencë heroike ka dhënë një kontribut vendimtar në dështimin e grushtit të shtetit.

Ishte gati të premtonte një bashkëpunim të ri, më të madh, me forcat demokratike, t'u njihje pushtetin e rritur dhe ndoshta shpresonte që të merrte në shkëmbim ndonjë duartrokitje dhe ngrohtësi, si viktimitë e një komplot që ka bërë të dridhet Bashkimi Sovjetik.

Por nuk ndodh kështu. Për një orë e gjysmë, në këmbë përpara një mikrofoni, duke dërsirë nën prozhektorët e telekamerave që filmojnë direkt fjalimin e tij, Gorbaçiov është shtrënguar pa dëshirë e tij që të marrë rolin jo të këndshëm e të akuzuarit përpara trupit gjyqës, gjithnjë e më shumë padurues me kalimin e minutave, gjithnjë e më pak i gatshëm që ta dëgjonte e ta justifikonte, thujse në ankth që t'i zhvasnin një rëfim, për paaftësi, në mos për faj.

E akuzojnë se ndjehet ende socialist, se nuk e konsideron të «jashtëligjshme»

Partinë Komuniste, se i ka zgjedhur ai, një për një, njerëzit që e kanë tradhëtuar duke i organizuar grushtin e shtetit dhe se ka vonuar reformat prej ankthit të tij në kërkimin gjithmonë të një konsensusi të përgjithshëm. Praktikisht, e dënojnë pse ka qenë një lider që beson tek moderimi dhe ndërmjetësimi si instrumenta për të dalë paqësisht nga diktatura.

I komanduar me shkop nga Jelcini si një nxënës shkolle, i ndërprerë vazhdimisht nga deputetët që i janë ulur përballë, i kontestuar dhe i përqeshur nga një audiencë që sot e konsideron ka mundësi me ndonjë bazë vërtetësi si qendrën e vërtetë të pushtetit e të gjithë vendit, Presidenti sovjetik vuan një trajtim edhe më shokues kur lë Parlamentin: një turmë prej 2000 njerëzish, partizanë të rezistencës ndaj puçistëve, e bllokun për gjysmë ore kortezhin e tij të limuzinave, e fishkëllen gjatë, duke i ulëritur «Gorbaçiov, gjaku i të vdekurve tanë është në duart tuaja», «Gorbaçiov, vendi jot është në bangën e të akuzuarve».

Dhe në fund vetëm një kordon prej 30 gardistësh të armatosur i kanë mundësuar që të kthehet në Kremlin. Është një proces ai që po asistojmë në sallën e Sovjetit Suprem rus: një spektakël forcë të ashpër nga njëra anë dhe i një dobësie tronditëse nga ana tjetër.

Kuptohet me njëherë se për të gjërat nuk janë mirë. Kur hyn në podiumin e presidencës, bashkë me Jelcinin, e pret një heshitje e akullit. Jelcini i jep jetë një duartrokitjeje, por rrahja e duarve zgjat vetëm shumë pak minuta.

Një duartrokitje krejt e ndryshme shpërthen kur Gorbaçiov, pasi ka marrë mikrofonin, falenderon Parlamentin rus «dhe në mënyrë të veçantë Presidentin Boris Nikollajevič Jelcin» pse ka fituar sfidën me puçistët: deputetët ngrihen në këmbë në unison, duke duartrokitur me entuziazmin e një stadiumi futbolli. Ajo që ka ndodhur më pas, meriton që të referohet thujse stenografikisht, tamam si në debatimet gjyqësore.

Gorbaçiov: «...6 vite prestrojke, reforma, e kanë ndryshuar thellësisht vendin...».

Zë nga salla: «Vazhdo më tej, këtë e dimë prej kohësh!».

Gorbaçiov: «...populli nuk e ka pranuar grushtin e shtetit, forcat e armatosura nuk qenë të gatshme të rreshtohen kundër popullit dhe reformave...».

Një zë: «Vazhdo, dil aty ku duhet!».

Një tjetër: «Çfarë thua, nuk është e vërtetë!».

Një tjetër akoma: «Fol konkretisht, na informo!».

Gorbaçiov (dukshëm i irrituar): «Çfarë doni, që t'ju përsëris ato që kam thënë dje në konferencën për shtyp? Apo nuk e keni dëgjuar?».

Murmurima kundërshtimi, fishkëllima.

Jelcini (nga mikrofoni në tryezën e podiumit): «Shokë, ju lutem, mbani qetësi».

Gorbaçiov: «Mirë, mirë, po deshët lajme, ja ku i keni». Dhe komunikon vendimet e marra në mënjësi, në mbledhjen me Jelcinin dhe liderët e 8 republikave të tjera sovjetike: emërimet e 3 ministrave të tij, atij të Mbrojtjes, të Brendshëm dhe kreun e KGB, të gjithë progresistë, të gjithë të pranuar nga Jelcini.

Salla duartroket. «Po mbledh akoma informacione lidhur me atë që ka ndodhur në ditët e komplotit, por mund t'ju them me siguri që të paktën 2 anëtarë të qeverisë nuk më kanë tradhëtuar, ministri i Kulturës Gubenko, që është rreshtuar kundër...».

Zëra nga salla: «Përralla!».

Gorbaçiov (duke ju drejtuar deputetit që ka folur): «Pse? Në një moment të parë ka heshtur, por më pas ka dhënë dorëheqjen në shenjë proteste...».

Zë: «Vonë, shumë vonë!».

Zë tjetër: «Turp!».

Gorbaçiov: «... gjithsesi, tjetri që më ka qëndruar besnik është zëvendëskryeministri Sherbakov, i cili...».

Shpërthen rrëmuja: «Jo, jo, përralla, nuk është e vërtetë, ka tradhëtuar, është si të tjerët, janë të gjithë puçistë!» në një kor ulërimash e britmash. Jelcini ngrihet në këmbë,



shkon në anë të podiumit ku po flet Gorbaçiov, i zgjat një copë lettër, kthen mikrofonin nga vetma dhe i thotë sallës: «Kjo është një përmbledhje stenografike e seancës së Këshillit të Ministrave e 20 gushtit, nga ku rezulton se të gjithë janë fajtorë ose nuk i janë kundërvënë grushtit të shtetit». Pastaj kthehet të ulët në vendin e tij. Gorbaçiov: «Por unë vërtet nuk e kam lexuar akoma...».

Jelcini: «Lexoje!».

Gorbaçiov: «Por Primakovi (këshilltari i tij ekonomik, shënimi im) më ka thënë se...».

Jelcini (i irrituar dhe me zë të lartë): «Mikhail Sergejeviç, të lutem lexojeni atë dokument, tani, këtu!».

Gorbaçiov (konfuz, i sikletosur): «...Po, jo, tani e lexoj, më parë dua të përfundoj diskutimin që po mbaja».

Tregon se ka pritur në Kremlin Ministrin e Jashtëm Bessmertnykh, thotë i bindur se nuk e ka dënuar hapur sa duhet grushtin e shtetit dhe për këtë i ka kërkuar që të japë dorëheqjen. Duartrokitje.

Një ulërimë: «Shevardnadze, rimerr Shevardnadze!».

Ulërimë tjetër: «Jo, Shevardnadze e mbajmë ne! Shumë e lehtë! Duhej të mendohesh më parë!».

Një zë: «Dokumentin, lexoj, po e lexon apo jo?».

Gorbaçiov: «Prisni, do të doja të thoja një gjë tjetër. Dua të them se puçistët donin të n asgjësonin, të na shtypin dhe për këtë duhet të ndëshkohen, ama në bazë të ligjit. Duhet të jemi të gjithë të përgjegjshëm, të ekuilibruar, të mos i japim rrugë një gjuetie shtrigash...».

Salla shpërthen, ulërima, fishkëllima, nuk dëgjohej më asgjë.

Jelcini: «Urtë, shokë, urtë!».

Gorbaçiov (i dëshpëruar): «Ju lutem! Ju lutem! Mos harroni se keni përpara vetes një qenie njerëzore. Situata ime nuk është e thjeshtë. Unë them atë që mendoj, e gjitha këtu, çfarë doni më tepër?».

Presidenti vazhdon: «Kujtoni se rreziku më i madh, dhurata më e madhe që mund t'u bëjmë konservatorëve, reaksionarëve, është përçarja e dorcave demokratike...».

Një zë: «E kemi dëgjuar!».

Një tjetër: «Gjë e vjetër!».

Një i tretë: «Reaksionarët në burg! Nuk do të kemi më frikë nga asgjë!».

Gorbaçiov (i hutuar, hezitues): «Në rregull, tani po kaloj në leximin e dokumentit që më dha Boris Nikollajeviči...».

Zëra: «Shyqy! Më së fundi!».

Presidenti lexon përmbledhjen stenografike e mbledhjes së Këshillit të Ministrave, rezulton se anëtarët e

qeverisë së tij, të vënë përballë shkarkimit të Gorbaçiovit dhe gjendjes së jashtëzakonshme të shpallur nga puçistët, e pranojnë faktin e kryer njëri pas tjetrit, ndonjë shpreh rezerva, ndonjë tjetër thotë se i duhet të reflektojë pak më shumë dhe nuk e ndjen veten të aftë të thotë aty për aty as po, as jo.

Audienca shpërthen. «Turp! Do të na e paguajnë! Frikacakël!».

Gorbaçiov duket paksa i gjallëruar, i qëndron lojës, komenton me gjepte dhe me folje reagimet e ministrave që e kanë tradhëtuar: «Çfarë thoni për këtë? Më shumë puçistë sesa jo, nuk ju duket?». Për një tjetër, që deklarohet «paksa i paqartë», lëviz dorën sikur do të thotë «çvete, çvete».

Por pastaj arrihet tek Gubenko, ministri i Kulturës, që nga raporti stenografik duket në favor të grushtit të shtetit.

Zëra: «E shikon? Ka tradhëtuar edhe ai!».

Gorbaçiov: «Po, ama më pas ka dhënë dorëheqjen...».

Leximi arrin tek emri i Sherbakov, zëvendëskryeministri, që ka kërkuar më shumë kohë për t'u shprehur lidhur me grushtin e shtetit.

Zëra të përzier: «Maskarai i fëlliqur! Dhe ti thojë se ishte për t'u shpëtuar? Hekurat, në burg!».

Gorbaçiov (i dorëzuar): «Po, mendoj se qëndrimi i duhur është dorëheqja e të gjithë qeverisë dhe, nga ana tjetër, lidhur me këtë qemë dakord në mënjësi me Boris Nikollajevičin...».

Më së fundi një duartrokitje.

Gorbaçiov (i dekurajuar): «Duke kaluar në një temë tjetër, do të doja të thoja se dekretet e firmosura nga Presidenti i Rosisë Boris Jelcin në ditët e robërisë time kanë ligjshmëri të plotë. Tani duhet të ndryshojmë gjithçka, na duhet një qeveri e re koalicioni e mbështetur nga të gjitha republikat sovjetike, duhen riorganizuar forcat demokratike, punuar sëbashku...».

Jelcini (duke e ndërprerë): «Shokë, çfarë thoni nëqoftëse unë firmos një dekret tjetër për t'i pushuar aktivitetet e Partisë Komuniste të Federatës Ruse (më konservatorja brenda Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik, qartazi e implikuar në grushtin e shtetit, shëni im.)?»

Duartrokitje e gjatë entuziaste.

Jelcini: «Dekreti miratohet me aklamacion».

Gorbaçiov (duke bërë shenjë jo me dorë): «Mendoj se, se... Nuk e kuptoj çfarë po bëni. Do t'i takonte Sovjetit Suprem, jo, domethënë, sigurisht unë e respektoj Boris Nikollajevičin, por, një minutë,

sigurisht që nuk mund të thuhet se gjithë Federata Ruse e partisë është e përfshirë në grushtin e shtetit, janë miliona njerëz, miliona punëtorë e fshatarë, midis tyre ka shumë demokratë të sinqertë, ju siguroj për këtë, nuk mund të mohohet, ndalimi i aktiviteteve të Partisë Komuniste Ruse do të ishte gabim...».

Jelcini: «Atëhere të themi se aktiviteti është pezulluar, në pritje që Prokuroria të përcaktojë përgjegjësitë».

Gorbaçiov: «Ah, atëhere, në këtë rast...».

Pastaj fillojnë pyetjet.

Një deputet: «Ju besoni apo jo tek socializmi?».

Gorbaçiov: «Duhet pyetur se çfarë është socializmi, është një ideal që në një shoqëri pluraliste ka të drejtë të ekzistojë, nuk ju duket? Përndryshe kthehemi në metodat e së kaluarës».

Deputeti i dytë: «Ju jeni në favor apo kundër shpalljes së paligjshme të Partisë Komuniste të bashkimit Sovjetik, që është një prej idhtareve të grushtit të shtetit? Përgjigjuni qartë, po apo jo?».

Gorbaçiov: «Shokë, nuk duhet të kapemi nga histeria antikomuniste. Nëqoftëse partia, siç jam i bindur, do ta pranojë programin e rinovimit të paraqitur prej mete, do të bëhet një forcë demokratike, siç jemi të gjithë ne këtu brenda».

Fishkëllima, protesta, ulërima.

Deputeti i tretë: «Mikhail Sergejeviç, e kuptoni se tash e prapa është ju që keni nevojë për ne, nuk jemi ne ata që kemi nevojë për ju? E kuptoni? Hajde, përgjigju!».

Gorbaçiov (me një fije zëri): «Vërtet besoj se kemi nevojë për njëri tjetrin, është edhe një mësim nga grushti i shtetit...».

Deputeti i katërt: «Kush do të jetë kryeministër? Po

zëvendëspresidenti i ri?».

Gorbaçiov: «Kryeministri, do të thoja, duhet të vijë nga udhëheqësia e Rosisë. Kryeministri juaj Silajev më duket një kandidat i shkëlqyer. Ndoshta zëvendëspresidenti duhet të vijë nga republikat tona aziatike».

Disa duartrokitje të ndrojtura.

Pyetjet dhe përgjigjet e Gorbaçiovit vazhdojnë.

Jelcini ndërhyr për të propozuar se zëvendëspresidenti i Rosisë, Koloneli Rutskoj, është promovuar gjeneral: «Jeni dakord, Mikhail Sergejeviç?»

Gorbaçiov: «Sigurisht, patjetër, shumë mirë».

Jelcini: «Mirë, shokë, prej një ore e gjysmë Presidenti i vendit tonë është në këmbë duke na folur. Tani më duket se është momenti që ta lëmë në impenjimet e tij. E falenderoj edhe në emrin tuaj». Pastaj fillon duartrokitjen, deputet e ndjekin paqejf dhe Jelcini e shoqëron Gorbaçiovin drejt daljes.

Procesi ka mbaruar. I lodhur, i cilitur, ideatori i perestrojkës nxiton drejt daljes, si një i burgosur që ëndërronte prej kohësh të kthehej në liri.

(Nga libri "La fine dell'impero. Ultimo viaggio in Urss" i autorit Enrico Franceschini)

Përgatiti: ARMIN TIRANA / bota.al

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Duka: Turp për ne, Kosova na ka lënë prapa

TIRANË, 31 GUSHT - Presidenti i Federatës Shqiptarë të Futbollit, Armand Duka, e ka bërë një krahasim ndërmjet sportit në Kosovë, e veçanërisht futbollit, me atë të Shqipërisë. Në fjalën e tij para kryeministrit Edi Rama dhe të disa ministrave, Dukae u

shpreh se është trup që për tri vjet Kosova e ka kaluar Shqipërinë me 10 vende në renditjen e ligave të UEFA-s, ndërsa e përmendi edhe Ligjin e Sponsorizimit, i cili ende nuk është bërë një temë në shtetin shqiptar, shkruajnë mediet shqiptare. “Turp për mua dhe

për gjithë komunitetin, Kosova për 3 vjet na ka kaluar në 10 vende. Ka bërë Ligjin e Sponsorizimeve dhe na ka kaluar. Përveç basteve që po lejohen, e që ta ndihmojnë edhe sportin, duhen riparë një shtat i tërë ligjor”, ka thënë Duka.



Sigal Prishtina në Ligën ENBL

Prishtinë, 31 gusht - Kampionia e shumëfishtë e Kosovës, Sigal Prishtina, do të marrë pjesë në Ligën ENBL. Lajmi është konfirmuar nga vetë liga me një shkrim në uebsajtin e saj zyrtar. Gjithsesi Prishtina do të jetë pjesëmarrëse e kësaj lige, nëse nuk arrin që të hyjë në grupet e FIBA Europe Cup. “Bardhekaltrit” do të përballen me fituesin e çiftit çerekfinal ndërmjet Kalev/Cramo dhe Cedevita Junior më 28 shtator, në Jonava të Lituanisë, kurse në finale mund të përballen me Kapfenberg Bulls, Cbet Jonava ose SCMU Craiova. Më tutje tregohet për historinë e klubit prishtinas, që u themelua në vitin 1970, por ka një histori të pasur, duke fituar 13 herë titullin

në Kosovë, 15 herë Kupën dhe katër herë Superkupën. Kryeqytetasit kanë fituar dy herë Ligën Ballkanike, ndërsa më 2015 morën pjesë për herë të parë në FIBA Europe Cup, kurse suksesin më të madh e regjistruan në edicionin 2018-2019 kur hynë në top 16. Trajneri i klubit është Ekrem Memnun, që u rikthye pas 17 vjetësh. ENBL është themeluar në verën e vitit 2021 për klubit profesionistë të meshkujve nga Evropa Veriore, Qendrore dhe Lindore. Është krijuar për klubit që dëshirojnë të konkurrojnë ndërkombëtarisht në një nivel të lartë. Edicioni i parë përfshin skuadra nga Polonia, Republika Çeke, Lituania, Letonia, Estonia, Bjellorusia dhe Rusia.

SEASON 2022/23
European North Basketball League
BC SIGAL PRISHTINA
PLISAT



Morina dënohet me dy ndeshje

FERIZAJ, 31 GUSHT - Trajneri i skuadrës së Ferizajt, Arbnor Morina, është dënuar me dy ndeshje nga Komisioni Disiplinor i shkallës së parë pranë Federatës së Futbollit të Kosovës. Morina ishte ndëshkuar me karton të kuq në fund të takimit pas ofendimit që ia bëri gjyqtarit kryesor në ndeshjen Ferizaj - Drita. “Kryetrajneri i KF Ferizaj, Arbnor Morina, nr ID. 001903M64. Në minutën 90 ofendoi gjyqtarin kryesor të ndeshjes, me ç’rast u ndëshkua me karton të kuq direkt. Sipas raportit të gjyqtarit kryesor të

ndeshjes Ferizaj - Drita, bazuar në nenin 40, paragrafi 1, pika D e Rregullores disiplinore; Dënohet me 2 (dy) ndeshje mosushtrim të detyrës sipas radhës organizuar nga FFK-ja”, thuhet në njoftimin e Komisionit Disiplinor. Me dy ndeshje është dënuar edhe zyrtari i Dritës, Fatos Ramadani, i cili e ofendoi trajnerin Morina. Me dy ndeshje mosushtrim të detyrës është dënuar edhe ndihmëstrajneri i Trepçës '89, Seid Onbashi, për shkak të fyerjeve ndaj gjyqtarëve të ndeshjes, me ç’rast edhe u ndëshkua me karton të kuq.

Munishi para ndeshjes me Ballkanin: Të dielën do të jetë kënaqësi me qenë prishtinas

PRISHTINË, 31 GUSHT - FC Prishtina e ka nisur shumë mirë edicionin e ri në Superligën e Kosovës në futboll, ku pas tri ndeshjeve të luajtura ka 2 fitore dhe një barazim. Gjithsesi, skuadrën e trajnerit Ismet

Munishi të dielën e pret një punë e madhe ku do të ndeshet me kampionin në fuqi, Ballkanin. Kjo sfidë luhet nga ora 20:00 në stadiumin “Fadil Vokrri”. Tekniku bardhekaltër ka thënë për faqen zyrtare të klubit

se të dielën do të jetë kënaqësi të jesh prishtinas. “Të dielën mbrëma do të jetë kënaqësi me qenë prishtinas dhe anëtar i FC Prishtina. ‘Plisat’ do të japin leksion falas për ata që duan të mësojnë”, ka thënë Munishi.



Fofana te Chelsea: Jam këtu për të fituar trofe

LONDËR, 31 GUSHT - Skuadra Chelsea ka thyer rekordin e shpenzimeve britanike për një merkato transferimesh pas nënshkrimit të lojtarit 70 milionë paund, Wesley Fofana nga Leicester City. Fofana, 21 vjeç, i bashkohet klubit të

Stamford Bridge me një kontratë shtatëvjeçare. Para ardhjes së francezit, Chelsea kishte shpenzuar tashmë 193.1 milionë paund për lojtarët. Shpenzimet e tyre tani do të jenë 263 milionë paund pas ardhjes së qendërmbrojtësit.

“Dy ditët e fundit kanë qenë ditë vërtet të mëdha për mua dhe jam shumë i lumtur. Jam stërvitur këtë mëngjes me ekipin dhe është një ëndërr për mua. Jam shumë i emocionuar që filloj të luaj për tifozët dhe klubin. Unë jam këtu për të

fituar trofe, Champions League, Premier League, FA Cup, Carabao Cup, gjithçka. Erdha këtu për të fituar dhe klubi është ndërtuar për të fituar trofe, kështu që unë jam këtu për të vazhduar këtë”, ka thënë Fofana.



Halleri, fjalim emocionues pas sëmundjes me tumor, nuk i përmban lotët



AMSTERDAM, 31 GUSHT - Sebastian Haller ishte në lot teksa mbajti një fjalim emocionues në skenën e “Eredivise Awards”. Sulmuesi 28-vjeçar, i cili shënoi 21 gola për kampionët e ligës Ajax sezonin e kaluar, ishte golashënuesi më i mirë i Eredivisie në sezonin 2021/22, duke mposhtur lojtarë si Lois Openda, Ricky van Wolfswinkel dhe Vangelis Pavlidis në renditje. Për ta nderuar atë arritje, Haller mori trofeun “Willy van der Kuijlen”, ndërsa gruaja e tij, Priscilla, e shikonte nga ulëset. Kanë qenë disa javë tepër të vështira për reprezentuesin e Bregut të Fildishtë. Haller nënshkroi një marrëveshje katërvjeçare me skuadrën e Bundesligës, Borussia Dortmund, në korrik, pas një sezoni mbresëlënës, por më pas ai u diagnostikua me një tumor testikular pasi sulmuesi u ankua se nuk ndihej mirë në stërvitje. Ai u largua nga kampi i stërvitjes parasezonale të klubit në Zvicër dhe pati një operacion të suksesshëm menjëherë pas kësaj. Në fillim të kësaj jave, në një

intervistë me ESPN, sulmuesi ka thënë se “po ndihet vërtet mirë” pasi vazhdon të rikuperohet. “Kam nënshkruar për Dortmundin dhe gjithçka ishte në rregull. Mendoj se familja ime dhe të gjithë ishin mjaft të kënaqur me situatën. Dhe më pas nuk e di. Ndjeva diçka të pakëndshme në barkun tim. Dhe pastaj nga atje shkoi shumë, shumë shpejt. Të nesërmen në orën 9 të mëngjesit bëra një skanim MRI. Ata më thanë: ‘Oh, ne shohim diçka. Duhet të kontrollojmë përsëri’. Kështu që unë shkova të bëja një biopsi sepse ata menduan se ishte ndoshta një tumor. Kam bërë shumë ekzaminime në më pak se 24 orë, më duhej të prisja operacionin për t’u siguruar dhe për të ditur saktësisht se çfarë ishte. Ata e dinin drejtpërdrejt se ishte kjo (diagnoza). Kështu që unë isha vërtet me fat që i kisha të gjitha ato kontrole kaq të shpejta. Dhe tani e di”, ka thënë Haller. “Gjëja e parë që po mendoja ishte, ‘hajde, unë kam qenë këtu për 10 ditë ose dy javë dhe nuk

mund të luaj as për klubin’. Po mendoja që klubi të thoshte ‘nuk duket si një marrëveshje e mirë’, por kur e mendon vërtet, e di se nuk mund të bësh asgjë për të. Nuk është diçka që mund ta shmangësh. Kur ke këtë trajtim, ke pesë ditë në spital dhe je në krizë për 24 orë në pesë ditë. Nuk mund të lëvizësh, nuk mund të bësh asgjë. Je thjesht në shtrat. Është veçanërisht në atë moment që ju të humbni muskujt dhe aftësinë tuaj fizike”, ka shtuar sulmuesi. “Për momentin ndihem shumë mirë. Ndihem shumë mirë. Që nga dita e parë që u ktheva në shtëpi fillova të eci. Isha në palestër. Madje jam në të njëjtin nivel që isha disa muaj më parë. Kjo është një gjë e mirë, vetëm shpresoj që të vazhdoj kështu. Gruaja ime, mamaja ime, ishin këtu që të mund të haja mirë. Shumë njerëz më dhanë këtë besim për të kaluar. Më duhet t’u them të gjithëve se ndihem mirë dhe të sigurohem që shumë njerëz të kontrollohen”, ka shtuar Halleri derisa bashkëshortja e tij ishte në lot.

SHKURT

Devin Johnsoni përforcon KB Rahoveci

Klubi i basketbollit Rahoveci ka njoftuar se është përforcuar me basketbollistin Devin Johnson, i cili është lojtar i katërt i huaj për këtë klub. “Devin Johnson është lojtar i katërt i huaj që i bashkohet skuadrës sonë. Johnsoni është i gjatë 196 cm dhe luan në pozitat 2 dhe 3. Për Johnsonin është ky viti i katërt që paraqitet në Evropë, derisa paraqitet paraprake i pati në ligat elite të Bjellorusisë, Lituanisë dhe së fundmi asaj çeke. Më parë Johnsoni është paraqitur edhe në kolegjin e Universitetit të Torontos, ku mesataren e pikëve për ndeshje e kishte 20 pikë”, thuhet në njoftimin e KB Rahoveci.

Berisha nga Fenerbahçe kalon tek Augsburgu

Sulmuesi kosovar me pasaportë gjermane, Mërgim Berisha, është larguar zyrtarisht nga Fenerbahçe. Berisha ka qëndruar vetëm një vit te gjiganti turk dhe tani është rikthyer në Gjermani. Augsburgu ka fituar garën me skuadrat e tjera gjermane për huazimin e Berishës, ku kanë paguar 400 mijë euro. Ndërkohë klubi gjerman ka të drejtën e blerjes së futbollistit për katër milionë euro në fund të sezonit. Berisha tanimë është prezantuar nga klubi gjerman dhe ka marrë fanellën me numrin 11. Ai pritet të debutojë me Augsburgun në fundjavë përballë Hertha Berlinit.

Inzaghi: Na duhet një qendërmbrojtës

Interi fitoi ndaj Cremonese (3-1) në “San Siro”, por trajneri Simone Inzaghi ka thënë se skuadra e tij ka nevojë për një qendërmbrojtës. “Jam shumë i lumtur, fituar një ndeshje të vështirë ndaj një skuadre që grumbulloi më pak se sa meritonte, djemtë bënë mirë që fituan një ndeshje të rëndësishme përpara derbit të Milanos. Kemi nevojë për një qendërmbrojtës. Nuk di asgjë rreth fjalëve për një largim të Gosensit, por di të them se më duhet një qendërmbrojtës në ekip urgjentisht. Klubi e di shumë mirë që na duhet një i tillë. Kemi pesë mbrojtës, na duhen gjashtë sepse kemi shumë ndeshje për të luajtur. Kanë mbetur dhe pak orë nga përfundimi i merkatos dhe duhet me patjetër përforcim në repartin qendror të mbrojtjes”, ka thënë Inzaghi.

Tucheli: Chelsea, skuadër e lehtë për t’u mposhtur

Chelsea pësoi humbje nga Southamptoni (2-1). Trajneri Thomas Tuchel e ka pranuar se skuadra e tij është shumë e lehtë për t’u mposhtur. “Nuk e di nëse ‘shqetësim’ është fjala e duhur. Mua nuk më pëlqen aspak të humb. Është hera e dytë këtë sezon dhe nuk mendoj se është vështirë që të na mposhtë dikush dhe kjo nuk më pëlqen. Është shumë lehtë të na nxjerrësh nga baraspesha, të na mposhtësh, të na hutosh. Është shumë lehtë. Ndodhi ndaj Leeds. Duhet ta kuptojmë pse dhe të gjejmë zgjidhje”, ka thënë Tuchel.

Ruizi kalon te PSG-ja

Paris Saint-Germain ka nënshkruar zyrtarisht me Fabian Ruiz nga Napoli në një marrëveshje që besohet të jetë me vlerë 21.5 milionë euro plus

bonuset. Skuadra e Ligës 1 njoftoi transferimin e spanjollit, ashtu si Napoli. Lojtari ka nënshkruar një kontratë pesëvjeçare deri në qershor

2027. Fabian Ruiz ishte në vitin e fundit të kontratës së tij me Napolin dhe kishte refuzuar zgjatjen e marrëveshjes, kështu që u desh të shitet këtë verë për

të mos e humbur falas. 26-vjeçari spanjoll ishte nënshkruar nga Real Betis në korrik 2018 për 30 milionë euro, një lëvizje e kërkuar nga trajneri

i atëhershëm Carlo Ancelotti dhe djali i tij Davide. Ai bëri 166 paraqitje për Napolin, duke kontribuar me 22 gola dhe 15 asistime.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate



Bazuar në nenin 79, 80 dhe nenin 81, paragrafi 2, nën paragrafi 2.2 të Ligji nr. 06/L-114 për Zyrarët Publikë nën 8 të Ligjit Nr.03/L-212 i Punës, Policia e Kosovës shpall:

KONKURSIN

Referenca: [07/1-01SAP-R/584/2022](#)

Për plotësimin e vendeve të punës

- Titulli i vendit të punës:** Automekanik- dhjetë (10) vende të lira pune
Vendi i punës: Drejtoria e Logjistikes/Flota Operative
Koeficienti: 6
Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të caktuar, një (1) vit
Orari i punës: i plotë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgjegjës për servisimin e rregullt të Automjeteve të PK-së konform planifikimit dhe kërkesave për të siguruar që të gjitha automjetet e PK-së të jenë funksionale.
- Identifikon nevojat për pjesë rezervë dhe njofton mbikëqyrësin dhe përgjegjës për servisimin/riparimin e automjeteve të aksidentuara të PK-së.
- Përgjegjës për riparimin, mënjanimin e problemeve mekanike të automjeteve duke siguruar që të jenë konform prishjeve në automjet duke caktuar prioritetet dhe duke informuar me kohë mbikëqyrësin.
- Identifikon nevojat për pjesë rezervë, njofton mbikëqyrësin, analizon dhe vlerëson faktorët më të shpeshtë të prishjeve të automjeteve.
- Bënë vlerësimin e kualitetit të pjesëve të ofruara nga kontraktori si dhe njofton mbikëqyrësin për mangësitë eventuale.
- Nëse vëren se prishja e automjetit është shkaktuar si pasojë e pa përgjegjësisë së vozitësit ta njoftoj mbikëqyrësin për procedura të mëtuajtshme.
- Për çdo riparim në automjet është përgjegjës të jetë konform standardeve teknike të aprovuara.
- Kujdeset që çdo riparim në automjete të jetë sipas radhës dhe nevojave urgjente të paraqitura si dhe është përgjegjës për koordinimin e punës me njësit tjera të servisit që çdo riparim të jetë i kompletuar sipas nevojave të paraqitura për riparim të automjetit.
- Të ruaj sekretin e institucionit, duke mos nxjerrë në opinionin publik informata që nuk janë në kompetencën e tij.
- Kryen edhe detyra tjera që janë të ndërlidhura me këtë natyrë të punës sipas kërkesës së mbikëqyrësit dhe kualifikimeve që posedon.

- Titulli i vendit të punës:** Autolimar- Pesë (5) vende të lira pune
Vendi i punës: Drejtoria e Logjistikes/Flota Operative
Koeficienti: 6
Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të caktuar, një (1) vit
Orari i punës: i plotë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgjegjës për riparimin të automjeteve të aksidentuara të PK-së konform planifikimit dhe kërkesave për të siguruar që të gjitha automjetet e PK-së të jenë funksionale.
- Përgjegjës për mënjanimin e dëmtimeve mekanike të karoseris së automjeteve duke siguruar që të jenë konform prishjeve në automjet duke caktuar prioritetet dhe duke informuar me kohë mbikëqyrësin.
- Identifikon nevojat për pjesë rezervë dhe njofton mbikëqyrësin dhe analizon e bën identifikimin e pjesëve të dëmtuara që mund të riparohen.
- Bënë vlerësimin e kualitetit të pjesëve të ofruara nga kontraktori si dhe njofton mbikëqyrësin për mangësitë eventuale.
- Nëse vëren se prishja e automjetit është shkaktuar si pasojë e pa përgjegjësisë së vozitësit ta njoftoj mbikëqyrësin për procedura të mëtuajtshme.
- Për çdo riparim në automjet është përgjegjës të jetë konform standardeve teknike të aprovuara.
- Kujdeset që çdo riparim në automjete të jetë sipas radhës dhe nevojave urgjente të paraqitura.
- Përgjegjës për koordinimin e punës me njësit tjera të servisit që çdo riparim të jetë i kompletuar sipas nevojave të paraqitura për riparim të automjetit.
- Të ruaj sekretin e institucionit, duke mos nxjerrë në opinionin publik informata që nuk janë në kompetencën e tij.
- Kryen edhe detyra tjera që janë të ndërlidhura me këtë natyrë të punës sipas kërkesës së mbikëqyrësit dhe kualifikimeve që posedon.

- Titulli i vendit të punës:** Autoelektricit- Tri (3) vende të lira pune
Vendi i punës: Drejtoria e Logjistikes/Flota Operative
Koeficienti: 6
Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të caktuar, një (1) vit
Orari i punës: i plotë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Përgjegjës për riparimin dhe instalimin elektrik në automjetet e PK-së konform planifikimit dhe kërkesave për të siguruar që të gjitha automjetet e PK-së të jenë funksionale.
- Përgjegjës për riparimet dhe instalimet elektrike të jenë konform prishjeve në automjet duke caktuar prioritetet dhe duke informuar me kohë mbikëqyrësin.
- Identifikon nevojat për pjesë rezerve dhe njofton mbikëqyrësin për furnizim.
- Vlerëson dhe bënë identifikimin e pjesëve të dëmtuara që mund të riparohen.
- Bënë vlerësimin e kualitetit të pjesëve të ofruara nga kontraktori si dhe njofton mbikëqyrësin për mangësitë eventuale.
- Nëse vëren se prishja e automjetit është shkaktuar si pasojë e papërgjegjësisë së vozitësit ta njoftoj mbikëqyrësin për procedura të mëtuajtshme.
- Për çdo riparim në automjet është përgjegjës të jetë konform standardeve teknike të aprovuara.
- Kujdeset që çdo riparim në automjete të jetë sipas radhës dhe nevojave urgjente të paraqitura.

- Përgjegjës për koordinimin e punës me njësit tjera të servisit që çdo riparim të jetë i kompletuar sipas nevojave të paraqitura për riparim të automjetit.
- Kryen edhe pune tjera sipas kërkesës së mbikëqyrësit dhe kualifikimeve që posedon.

- Titulli i vendit të punës:** Teknik metalpunues (axhustator)- dhjetë (10) vende të lira pune
Vendi i punës: Drejtoria e Logjistikes/Flota Operative
Koeficienti: 6
Kohëzgjatja e emërimit: Me afat të caktuar, një (1) vit
Orari i punës: i plotë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Punimin e grilave, të dritareve, për vendosjen e tyre në Qendrat e Mbatjes, nëpër objektet e PK-së.
- Punimin e grilave të dritareve, për vendosjen e tyre në dhomat e dëshmimeve, në objektet e PK-së.
- Punimin e grilave të dyerve për vendosje në dhomat e dëshmimeve në objektet e PK-së.
- Riparimin të rrethojave të objekteve për shkaqe sigurie.
- Vendosjen e grilave metalike të objekteve në hapësirat me konfidencialitet të veçantë.
- Ndërrimin e dyerve metalike, në dhomat e dëshmimeve dhe qendrat e mbajtjes.
- Vendosjen e dyerve metalike në dhomat me konfidencialitet të veçantë.
- Vendosjen e bravave mbrojtëse, nëpër dyer metalike.
- Kryen detyra tjera sipas udhëzimeve të dhëna nga Udhëheqësi i Njësisë së Teknikëve.

Shkollimi dhe shkathësitë për të gjitha pozitat e kërkuara:

- Të posedoj diplomë të shkollës së mesme.
- Së paku 1 vit përvojë pune.
- Trajnim përkatës.
- Aftësi profesionale dhe motivuese.
- Posedim të standardeve të lartaetike.
- Të ketë aftësi për të punuar në grup, në ambient multietnik.
- Të ketë shkathësi të dëshmuara të komunikimit me shkrim dhe me gojë.
- Nivel të lartë të ndershmërisë dhe konfidencialitetit.

Kërkesat e përgjithshme për pranimin e Nëpunës administrativ dhe mbështetës janë:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të zotërojë një rënë nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët.
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse.
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.
- Të kenë nivelin e arsimit dhe përvojën e punës të kërkuar për pozitën, kategorinë, klasën apo grupin përkatës, dhe
- Të kalojnë me sukses procedurat e pranimit, sipas këtij ligji.

Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim:

- Formulari për aplikim;
- Deklarata (lidhur me pajtueshmërinë e hetimeve të së kaluarës), mund ta shkarkoni në ueb-faqen e Policisë së Kosovës www.kosovopolic.com ku gjendet shpallja e konkursit dhe pas nënshkrimit nga aplikanti i bashkëngjitet aplikacionit;
- Kopja e diplomës për arsimin e kërkuar, ndërsa për kandidatët që kanë përfunduar shkollimin jashtë vendit kopjen e diplomës të notifikuar;
- Dëshmi për kualifikime tjera, dëshmi për përvojën e punës;
- Certifikata /ekstraktin e lindjes;
- Vërtetimi nga gjykata që nuk është i dënuar dhe që nuk është nën hetime;
- Kopja e letërnjoftimit ose pasaportës valide;
- Një fotografi të formatit (5 x 5);
- Dokumentet nga pika e dhe f duhet të jenë të vlefshme dhe të nxirren pas datës së shpalljes së konkursit.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:

Bazuar në aktet ligjore të lartpërmendura të gjitha aplikacionet dhe dokumentacioni i pranuar do të shqyrtohet me kujdes dhe gjatë shqyrtimit nëse konstatohet se kandidati nuk i plotëson kriteret e përcaktuara për aplikim dhe punësim, apo nëse aplikacioni përmban të dhëna të rrejshme kandidati menjëherë do të diskualifikohet. Kandidatët e suksesshëm do të ftohen të marrin pjesë në intervistë. Këto pozita i nënshtrohen procesit të verifikimit dhe mund të plotësohet vetëm pas përfundimit të suksesshëm të procesit të verifikimit.

Në fund të procesit përzgjedhës kandidatët e pazgjedhur kanë të drejtë në ankesë.

Informimi i kandidatëve lidhur me rezultatet do të publikohet në ueb - faqen e Policisë së Kosovës, në adresën: www.kosovopolic.com, te rubrika mundësi e punësimit.

Data e fillimit dhe e mbylljes së konkursit:

Konkursi do të jetë i hapur 15 ditë nga data **31.08.2022** deri me **14.09.2022**.

Mënyra e aplikimit:

Formularët duhet t'i dorëzohen në Njësinë për Rekrutim dhe Seleksionim, Ndërtesa e re e Administratës, DPP, Prishtinë, personalisht ose dërgohen me postë në këtë adresë: **Policia e Kosovës, rr. "Luan Haradinaj", 10000 Prishtinë, Njësia e Rekrutimit dhe Seleksionimit, kati i III, zyra 54**, çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 deri në afatin e fundit për konkurrim. Dokumentet e pranuar nuk do të kthehen!

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara mund të refuzohen.

Formularët për aplikim janë në dispozicion në ueb-faqen e Policisë së Kosovës www.kosovopolic.com ku gjendet shpallja e konkursit.

Numrat kontaktues: Për informata plotësuese mund të thirrni në numrin e telefonit kontaktues nr.: 038- 5080 lokali: 1002 /038-504504 lokali:1751 dhe 038 245 184.

"Policia e Kosovës i shërben gjithë popullit të Kosovës. Ky shërbim ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe i mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë".



Republika Kosova
 Republika Kosova – Republic of Kosovo
 Qeveria – Vlada – Government
 Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
 Ministry of Internal Affairs
 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
 Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate



Na osnovu člana 79,80 i člana 81 stav 1. pod stava 2.2. Zakona br. 06/L-114 za Javne službenike, član 8 Zakona br. 03/L-212, o radu, Policija Kosova objavljuje:

KONKURS

Referencija: 07/ 1-01SAP-R/ 584/2022

Za popunjavanje radnih mesta

1. **Naziv radnog položaja:** Automehaničar- deset (10) slobodna radna mesta
Radno mesto: Direkcija Logistike / Operativna Flota
Koeficijent: 6
Vreme trajanja imenovanja: Na određeno vreme, jednu (1) godinu
Radno vreme: puno

Zadaci i odgovornosti:

- Odgovoran za redovno servisiranje Vozila PK-a, shodno planiranju i zahteva kako bise obezbedilo da sva vozila PK-a, budu funkcionalna.
- Identifikovanje potreba za rezervne delova i upoznavanje nadzornika i odgovornost za servisiranje/ opravku oštećenih vozila PK-a,
- Odgovoran za popravku, otklanjanje mehaničkih kvarova na vozilima, staranje o njihovoj uskladjenosti sa kvarovima na vozilu, postavljanje prioriteta i blagovremeno obaveštavanje nadzornika.
- Identifikuje potrebe za rezervnim delovima, obaveštava nadzornika, analizira i procenjuje najčešće faktore kvarova vozila.
- Procenjuje kvalitet delova koje je obezbedio od ugovarača i obaveštava nadzornika o svim eventualnim nedostacima.
- Ukoliko primetite da je kvar na vozilu nastao kao posledica neodgovornosti vozača, obaveštava nadzornika radi daljeg postupka.
- Za svaku popravku na vozilu, odgovoran je za uskladjenost sa odobrenim tehničkim standardima.
- Vodi računa o tome da svaka popravka vozila bude po porudžbini i iskazanim hitnim potrebama i odgovoran je za koordinaciju rada sa ostalim servisnim jedinicama kako bi svaka popravka bila završena prema iskazanim potrebama za popravku vozila.
- Da sačuva tajnost institucije, tako da ne daje u javnosti informacije a koje nisu u njegovu nadležnost.
- Obavlja i druge poslove koje su povezane sa njegovom prirodom poslova na zahtev nadzornika i kvalifikacije koje poseduje.

2. **Naziv radnog položaja:** Auto limar- Pet (5) slobodna radna mesta
Radno mesto: Direkcija Logistike/ Operativna Flota
Koeficijent: 6
Vreme trajanja imenovanja: Na određeno vreme, jednu (1) godinu
Radno vreme: puno

Zadaci i odgovornosti:

- Odgovoran za opravku osećanih Vozila PK-a, u udesima, shodno planiranju i zahteva kao bise obezbedilo da sva vozila PK-a, budu funkcionalna.
- Odgovoran za popravku, otklanjanje mehaničkih kvarova na vozilima, staranje o njihovoj uskladjenosti sa kvarovima na vozilu, postavljanje prioriteta i blagovremeno obaveštavanje nadzornika.
- Identifikovanje potreba za rezervne delova i upoznavanje nadzornika i analizira vrši identifikaciju rezervnih delova koje mogu da se popravljaju.
- Procenjuje kvalitet delova koje je obezbedio od ugovarača i obaveštava nadzornika o svim eventualnim nedostacima.
- Ukoliko primetite da je kvar na vozilu nastao kao posledica neodgovornosti vozača, obaveštava nadzornika radi daljeg postupka.
- Za svaku popravku na vozilu, odgovoran je za uskladjenost sa odobrenim tehničkim standardima.
- Stara se za svaku opravku na vozilima da buzde prema redosledu i hitnim opravdanim potrebama.
- Odgovoran za koordinaciju rada sa ostalim servisnim jedinicama tako da se svaka popravka završi prema iskazanim potrebama za popravku vozila.
- Da sačuva tajnost institucije, tako da ne daje u javnosti informacije a koje nisu u njegovu nadležnost.
- Obavlja i druge poslove koji su u vezi sa ovom vrstom poslova po zahtevu rukovodioca i kvalifikacijama koje poseduje.

3. **Naziv radnog položaja:** Auto električar-Tri (3) slobodna radna mesta
Radno mesto: Direkcija Logistike/ Operativna Flota
Koeficijent: 6
Vreme trajanja imenovanja: Na određeno vreme, jednu (1) godinu
Radno vreme: puno

Zadaci i odgovornosti:

- Odgovoran za opravku električnu instalaciju u Vozilima PK-a, u udesima, shodno planiranju i zahteva kao bise obezbedilo da sva vozila PK-a, kako bi bila funkcionalna.
- Odgovoran za popravku i električnu instalaciju da su uskladjena sa kvarovima na vozilu, postavljanje prioriteta i blagovremeno obaveštavanje nadzornika.
- Identifikuje potrebe za rezervne delove i obaveštava nadzornika sa snabdevanje.
- Vrši procenu i identifikaciju oštećenih delova koje mogu da se poprave.
- Procenjuje kvalitet delova koje je obezbedio od ugovarača i obaveštava nadzornika o svim eventualnim nedostacima.
- Ukoliko primetite da je kvar na vozilu nastao kao posledica neodgovornosti vozača, obaveštava nadzornika radi daljeg postupka.
- Za svaku popravku na vozilu, odgovoran je za uskladjenost sa odobrenim tehničkim standardima.

- Stara se za svaku opravku na vozilima da buzde prema redosledu i hitnim opravdanim potrebama.
- Odgovoran za koordinaciju rada sa ostalim servisnim jedinicama tako da se svaka popravka završi prema iskazanim potrebama za popravku vozila.
- Obavlja i druge poslove na zahtev nadzornika i kvalifikacije koje poseduje.

4. **Naziv radnog položaja:** Tehničar metaloprerađivač (varioca-mašinbravar) - deset (10) slobodna radna mesta
Radno mesto: Direkcija Logistike/ Operativna Flota
Koeficijent: 6
Vreme trajanja imenovanja: Na određeno vreme, jednu (1) godinu
Radno vreme: puno

Zadaci i odgovornosti:

- Rad rešetaka prozora, njihovo postavljanje u Centrima Zadržavanja, na objektima PK-a,
- Rad rešetaka prozora, njihovo postavljanje u Komorama dokaza, a objektima PK-a,
- Rad rešetaka vrata, njihovo postavljanje u Komorama dokaza, u objektima PK-a,
- Opravku ograda objekata iz bezbednosti razloga,
- Postavljanje metalnih rešetki objekata u prostore sa posebnom poverljivošću,
- Zamenu metalnih vrata, u komorama dokaza i centrima za zadržavanje,
- Postavljanje metalnih vrata u prostorijama sa posebnom poverljivošću,
- Postavljanje zaštitnih brava u prostorijama od posebne poverljivosti.
- Obavlja i druge poslove po nalogu Rukovodioca Tehničke Jedinice.

Obrazovanje i veštine za sve potrebne položaje:

- Da poseduje diplomu srednje škole
- Da ima najmanje 1 godinu, radnog iskustva,
- Odgovarajuću obuku
- Profesionalne i motivisane sposobnosti
- Posedovanje visokih etičkih standarda,
- Da je sposoban za rad u grupi, u multietničkom okruženju,
- Dokazane veštine pismene i usmene komunikacije,
- Visoki nivo poštenosti i poverljivosti

Opšti zahtevi za prijem Administrativnog Službenika i pomoćnika su:

- Da je državljanin Republike Kosova;
- Da je potpuno sposoban za rad;
- Da poznaje jedan od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- Da je zdravstveno sposoban za obavljanje odgovarajućih poslova;
- Da nije kažnjavan pravosnažnom odlukom za izvršavanje krivičnog dela;
- Da nema neku disciplinsku meru za razrešenje sa položaja javnog službenika, obustavljena po ovom zakonu.
- Da imaju nivo obrazovanja i radno iskustvo potrebno za odgovarajući položaju, kategoriju, klasu ili grupu; i
- Da uspešno položiti prijemne procedure, po ovom zakonu.

Potrebna dokumentacija za konkurisanje:

- FORMULARI za apliciranje;
- Izjava (u vezi sa usaglašenosti o istragama prošlosti) može se preuzeti sa ueb-stranice Policije Kosova www.kosovopolice.com gde se nalazi objavljivanje konkursu i nakon potpisivanja od strane aplikanta prilaže se aplikaciji;
- Kopija diplome o traženoj stručnoj spremi, dok za kandidate koji su školovanje završili u inostranstvu kopiju nostrifikovane diplome;
- Dokazi ostalih kvalifikacija, dokaz o radnim iskustvu;
- Sertifikat / Izvod rodnjeni;
- Potvrdu suda da nije kažnjavan i da nije pod istragom;
- Primerak lične karte ili važećeg pasoša;
- Jedna fotografija formata (5 x 5);
- Dokumenta iz tačke e i f moraju biti važeća i izdata posle datuma objavljivanja konkursa.

Zakonski i podzakonski akti koji regulišu regrutovanje:

Na osnovu navedenih zakonskih akata, sve prijave i pristigla dokumentacija biće pažljivo razmotrene i tokom pregleda, ukoliko se utvrdi da kandidat ne ispunjava kriterijume utvrdjene za prijavu i prijem u radni odnos, ili ako prijava sadrži lažne podatke, kandidat će biti odmah diskvalifikovan. Uspešni kandidati biće pozvani da učestvuju na intervjuisanje.

Ovi položaji podvrgavaju se procesu provere i mogu da se popunjavaju nakon uspešnog obavljanja postupka provere.

Na kraju izbornog procesa neizabrani kandidati imaju pravo žalbe.

Obaveštenje kandidata u vezi rezultata objaviće se na ueb-stanici Policije Kosova, na adresi www.kosovopolice.com, kod rubrike mogućnost zapošljavanja.

Datum početka i završetka konkursa:

Konkurs će biti otvoren 15 dana od **31.08.2022** do **14.09.2022** godine.

Način apliciranja

Obrasci se moraju dostaviti Jedinici za Regrutaciju i Selekciju, Nova Zgrada Administracije, GDP, Priština, lično ili poslato poštom na ovu adresu: **Policija Kosova, ul. "Luan Haradinaj", 10000 Priština, Jedinica za Regrutaciju i Selekciju, III-sprat kancelarija 54, svakog radnog dana od 09:00-15:00 do poslednjeg roka za konkurisanje.** Primljena dokumentacija neće se vratiti!

Zahtevi dostavljeni posle isteka roka neće se prihvatiti. Ne kompletirana dokumentacija može da se odbaci.

Obrasci za apliciranje su na raspolaganju na web stranici Policije Kosova www.kosovopolice.com gde se nalazi objavljivanje konkursa.

Brojevi za kontaktiranje: Za dodatne informacije možete pozvati na sledeće brojeve telefona za kontaktiranje: 038- 5080 lokal : 1002 /038-504504 lokal:1751 i 038 245 184.

"Policija Kosova služi celom narodu Kosova. "Policija Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građana Republike Kosova, i očekuje aplikacije od svih muškaraca i žena iz svih zajednica na Kosovu"

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Çeta - GeneralInvestGroup" sh.p.k Tubuhoc, Istog, në bashkëpunim me Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për centralin solar fotovolaik, 5.81 MW në Istog.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 29.09.2022 në ora 10:00 në hapësirat e restorant Sharaz -Wedding Hall. Carallukë, Lidhja e Pejës no.822, 31000 Istogdo të organizohet debat publik nga Kompania "Çeta - General Invest Group" sh.p.k Tubuhoc, Istog, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për centralin solar fotovolaik, 5.81 MW në Istog.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën ZOOM

<https://us04web.zoom.us/j/4549344495?pwd=NjkzeHFBUzJGZEc4dXUzeGx2NXVtZz09>
Meeting ID: 454

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për kompaninë "Çeta - GeneralInvestGroup" sh.p.k Tubuhoc, Istog për centralin solar fotovolaik, 5.81 MW në Istog.

https://mmphi.rks-gov.net/dokumentet_dhe_publicimet/279/publicimet

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "Fingermarket Corporation-Kosovo Branch Dega në Kosovë" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810850281 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Fingermarket Corporation-Kosovo Branch Dega në Kosovë" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810850281 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "Fingermarket Corporation-Kosovo Branch Dega në Kosovë" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 810850281 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage - mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156



+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Granit Krasniqi shpall të pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Efe Refeya shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Shpejtim Bytyci shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

